

RAPORT
MBI
VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË M.B.U.M.K
PËR VITIN 2011.

I.Organizimi, përbërja dhe funksionimi i strukturave të auditimit.

Në zbatim të nenit 18, pika 5, të Ligjit nr 9720, datë 23.04.2007 “ Për auditin e brendshëm në sektorin publik “ i ndryshuar me Ligjin nr 10318, datë 16.09.2010, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MBUMK, ka përgatitur raportin vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2011.

• **Statusi ligjor.**

Statusi ligjor në të cilën bazohet veprimtaria e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është në përputhje me:

- ✓ Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Auditimit të Brendshëm.
- ✓ Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010.
- ✓ Urdhëri nr. Nr. 69, datë 29.09.2010, “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”
- ✓ Rregulloren e brendëshme të organizimit dhe funksionimit të DAB në MBUMK.
- ✓ Planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2010-2013.
- ✓ Planin vjetor të auditimit.
- ✓ Kodin Etik.

• **Misioni dhe objektivat.**

✓ **Misioni** i DAB është shqyrtimi, vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmëri të burimeve financiare dhe njerëzore.

Objektivat kryesore të DAB.

Në funksion të përmbushjes së misionit të saj, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese për vitin 2011 kanë qenë:

- auditimi i përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e mirëadministrimit financiar si dhe auditimin e zbatimit të ligjëshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare.
- parashikimin e rreziqeve në sistemin e kontrollit të brendshëm, gjatë procesit të vlerësimit të riskut.
- zbatimi dhe respektimi i procedurave të tenderimeve në përdorimin e fondeve për investime.
- dhënia e rekomandimeve dhe të kërkesave për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë.

Struktura organike e auditimit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, përbëhet nga 5 auditë: 1 Drejtor dhe 4 auditë.

Auditët kanë përfunduar trajnimin pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Auditimit në periudhën Mars 2007- Qershor 2008, janë certifikuar si “**Auditë të brendshëm në sektorin publik**”, dhe kanë vjetërsi në punë mbi 10 vjet në auditim.

- **Programimi i auditimeve, hartimi i tematikave të auditimit.**

Që në fazën e programimit të subjekteve dhe të tematikave të auditimit, jemi mbështetur në këto kritere :

- ✓ Përfshirjes në plan të subjekteve të cilet mbartin risk të lartë.
- ✓ Në rëndësinë e subjekteve dhe të drejtimeve të auditimit.
- ✓ Në përcaktimin e afatit të auditimit prej jo më pak se një herë në dy vjet.
- ✓ Në rezultatet përfundimtare të auditimit të mëparshëm, rekomandimet e dërguara.

• **Metodologjia e auditimit.**

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2011, një drejtim mjaft i rëndësishëm i veprimtarisë së DAB, ka qenë vlerësimi dhe zbatimi i standarteve të auditimit.

Proceset e auditimit të realizuara nga DAB, janë karakterizuar me:

- njohjen paraprake të natyrës së subjektit që auditohet,
- përcaktimin e drejtimeve dhe çështjeve që do të mbulojë auditimi,
- vlerësimin e riskut dhe materialiteti,
- transparentën dhe metodën e ballafaqimit me personat përgjegjës.
- objektiviteti dhe paanësia në vlerësim,
- përgatitjen e dokumentacionit të auditimit dhe masave rekomanduese.

II.Hartimi dhe realizimi i programeve nga strukturat e auditit.

✓ Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në MBUMK, gjatë kësaj periudhe, ka synuar kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm, në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efikasitetit, në zbatim të nenit 7, të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, Kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. Nr. 69, datë 29.09.2010, “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Në Programin vjetor të auditimit (të miratuar nga Ministri me shkresën nr. 5871 prot. datë 18.11.2010, **për periudhën Janar-Dhjetor 2011 janë programuar dhe miratuar për tu kryer gjithsej 32 auditime**, ku do të mbulohehin të gjitha fushat dhe sistemet e duhura të institucioneve që do të auditohen, bazuar në pikën 1.5.2. të Kapitullit të I të Manualit.

➤ **Auditimet e kryera në vitin 2011 nga DAB.**


Për vitin 2011 janë programuar dhe miratuar për tu kryer gjithsej 32 auditime nga të cilat:

23 auditime të plota dhe,
9 auditime të pjesëshme,

Për periudhën vitin 2011 janë realizuar 38 auditime, nga të cilat:

24 auditime të plota,
12 auditime të pjesëshme dhe
2 auditime të plota janë në proces.

Nga përllogaritjet e ngarkesës për çdo auditues, kanë rezultuar mesatarisht **7.6 objekte të audituara.**



Plani i auditimeve per vitin 2011 është realizuar në masën 118 % ose 6 auditime me shumw.

Nga 38 misionet e auditimit të realizuara gjatë vitit 2011 janë evaduar 36 misione dhe 2 prej tyre janë në proces.

A. Misione auditimi të plota:

- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë (evaduar viti 2011)
- DRB Dibër
- DRB Lezhë
- BK Vlorë
- DRB Gjirokastrë
- Q.T.T.Bujqësore Vlorë
- BK Kukës
- DRB Berat
- DRB Elbasan
- QTTB Shkodër
- QTTB Lushnje
- B.K. Shkodër
- B.K. Fier
- B.K. Lushnje
- QTTB Korçë
- B.K. Durrës-Krujë
- B.K.Elbasan
- B.K.Mat
- B.K.Gjirokastrë
- DRB Kukës
- DRB Vlorë

- B.K. Lezhë

Misione auditimi të plota në poçes:

- B.K. Tiranë
- B.K. Berat

B. Misione auditimi te pjeseshme

- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve Tiranë
- QTTB Vlorë
- B.K.Elbasan
- B.K.Korçë
- QTTB Fushë Krujë + DRB Korçë
- B.K.Vlorë "Rikons i pjesshëm i argjinaturës Selevac-Panaja
- Verifikim i pajisjeve në ISUV Tiranë
- Infrastruktura e kullimit për vitin 2011 në B.K. Fier
- Infrastruktura e kullimit për vitin 2011 në B.K. Korçë
- Infrastruktura e kullimit për vitin 2011 në B.K. Tiranë
- Infrastruktura e kullimit për vitin 2011 në B.K. Lezhë
- Rehabilitimi i nënobjekteve Has Tropojë

B/1. Misione auditimi investigimi dhe mbikqyrje:

- Zbatimi I VKM nr. 472,
- Zbatimi rekomandimeve vitit 2011

Nga auditimi i fondeve për investime, për rehabilitimin e infrastrukturës së kullimit, ujitjes dhe mbrotjes nga përmbytjet u konstatuan të meta dhe bobësi në drejtim të: Administrimit dhe përdorimit ligjor i fondeve buxhetore të cilat nuk janë kryer konformë rregullave në fuqi. Shpenzimet operative për infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrotjes nga përmbytja nuk janë kryer në përputhje me projekt preventivin e objektit. Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar si një proces i vazhdueshëm ose, pothuajse nuk ka funksionuar fare, gjë e cila reflektohet në mungesën e bashkërendimit të punës ndërmjet Sektorit Teknik, Degës së Financës dhe Sektorit Mekanik dhe Hidrovorë, si dhe mos kërkesa e llogarisë nga ana e Drejtorit Ekzekutiv në drejtim menaxhimit me efektivitet të fondeve buxhetore, të zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve ligjore në fuqi në procedurat e punës së tyre, *duke bërë në këtë rast që vlersimi i riskut të jetë në nivele të larta.*

Nuk janë hartuar situacionet mujore të punimeve të kryera në objekt nga Dega Teknike dhe të kontrolluara nga mbikqyrësi i punimeve e percaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet mbikqyrësit të punimeve dhe Bordit të Kullimit Korçë.

Marrja në dorëzim e projekt preventivave është bërë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 13.05.2005 të K.M.

Shpërndarja dhe dokumentimi i karburantit nuk bëhet konform me Urdhërin e Ministrit BUMK, nr. 588, datë 27.12.2005, "Për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe lëvizjen e makinerisë së rëndë".

➤ ***Pasqyrimi i zbulimeve, shkeljeve ligjore dhe dëmet e shkaktuara për vitin 2011.***

Gjatë auditimeve janë zbuluar dhe evidentuar të meta, mangësi dhe dukuri negative me pasoja ekonomike.

Konkretisht:

Për periudhën *Janar-Dhjetor 2011*, zbulimet rezultojnë si më poshtë:

Nga struktura qëndrore e DAB në MBUMK, zbulimet në total rezultojnë në vlerën **36 917.6 mijë lekë** e konkretisht:

A. *Të ndara sipas auditimeve me bazë sistemi:*

I. Sistemet e proceseve organizative, të cilat rezultojnë në vlerën prej **4 744.5 mijë lekë**.

Kjo vlerë rezulton nga mosshlyerja e detyrimeve të prapambetura nga rekomandimet e lëna në vlerën prej 456.8 mijë lekë, sa paguar ore jashtë orarit si dhe pagë në mospërputhje me pozicionin e punës etj në vlerën prej 4 287. 7 mijë lekë.

II. Sistemi i pagesave të cilat rezultojnë në vlerën prej **30 739 mijë lekë**.

Kjo shumë është rezultat i diferencave të punimeve të ndërtimit, për sa përfituar ditët e pushimit vjetor, mosplotësim të kushteve të kontratës etj.

III. Sistemi i prokurimeve të cilat rezultojnë në vlerën prej **1 434 mijë lekë**

Kjo shumë është rrjedhojë e ndryshimit të zërave të punimeve të parashikuara në kontratë.

B. *Të ndara sipas subjekteve gjetjet dhe zbulimet janë:*

- ✓ QTTB Fushë Krujë në vlerën **prej 717 913 lekë**.
- ✓ DRB Dibër në vlerën **prej 844 696 lekë** .
- ✓ BK Vlorë në vlerën **prej 378 566 lekë**.
- ✓ DRB Lezhë në vlerën **prej 542 858 lekë**
- ✓ QTTB Vlorë në vlerën **prej 9 904 617 lekë**
- ✓ DRB Gjirokastër në vlerën **prej 1 076 218 lekë**
- ✓ B.K. Kukës në vlerën **prej 468 154 lekë**
- ✓ ESHFF Tiranë në vlerën **prej 52 670 lekë**
- ✓ DRB Elbasan në vlerën **prej 507 515 lekë**
- ✓ QTTB Lushnje në vlerën **prej 352 626 lekë**
- ✓ B.K. Shkodër në vlerën **prej 732 748 lekë**
- ✓ B.K. Fier në vlerën **prej 1 869 739 lekë**
- ✓ Q.T.T.B. Korçë në vlerën **prej 297 826 lekë**
- ✓ B.K.Durrës-Krujë në vlerën **prej 26 334 lekë**
- ✓ DRB Durrës në vlerën **prej 5 810 lekë**
- ✓ DRB Kukës në vlerën **prej 13 849 lekë**
- ✓ B.K. Elbasan në vlerën **prej 226 527 lekë**
- ✓ B.K. Mat në vlerën **prej 386 423 lekë**
- ✓ B.K. Gjirokastër në vlerën **prej 32 250 lekë**
- ✓ B.K. Korçë në vlerën **prej 10 841 637 lekë**
- ✓ DRB Kukes në vlerën **prej 45 958 lekë**
- ✓ DRB Vlore në vlerën **prej 829 244 lekë**
- ✓ B.K. Lezhe në vlerën **prej 6 763 092 lekë**

• *Masa disiplinore dhe administrative për shkeljet dhe dëmet e shkaktuara.*

Për të gjitha të metat, mangësitë dhe shkeljet e disiplinës financiare të konstatuara, auditët kanë ndërhyrë duke rekomanduar masa organizative për përmirësimin e gjendjes.

Masat rekomanduese lidhen kryesisht me përcaktimin e rrugëve dhe drejtimeve që mundësojnë mbylljen e shtigjeve për veprime të kundërligjshme dhe abuzive për fondet publike. Këto masa janë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe kur ka vend edhe disiplinor, të zhdëmtimit, administrativ.

Per vitin 2011, **jane dhënë gjithsej 231 rekomandime dhe propozime, të ndara si vijon :**

- **për përmirësimin e sistemeve të organizimit të kontrollit të brendshëm, janë dhënë 157 rekomandime,**
- **për 16 persona, janë rekomanduar masa disiplinore, nga të cilet 2 drejtues entitetesh.**
- **në 58 raste, janë rekomanduar masa zhdëmtimi në shumën 36 261.3 mijë lekë.**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2011 ka :

- ✓ mbikqyrur procesin e ndjekjes së rekomandimeve për të monitoruar dhe për tu siguruar që veprimet e menaxhimit janë zbatuar me efektivitet ose për të evidentuar që drejtuesit e nivelit të lartë të menaxhimit e kanë pranuar riskun që vjen nga mos ndërmarrja e veprimeve korigjuese për zbatimin e rekomandimeve të miratuara.
- ✓ *proçeduar dhe mbikqyrur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera nga ana saj në entitete e varësisë.*

Nga Titullari i Institucionit me shkresën nr. 5871, prot. datë 18.11.2010, është miratuar “Programi Vjetor i Auditimeve për vitin 2011”, në tremujorin e katërt të këtij viti, ishte programuar auditimi tematik për : *“Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi”*.

Në mbështetje të Kap. IV, të Urdhërit të Kryeministrit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, **në adresë të 27 Subjekteve** të përcaktuara në listë për verifikim të zbatimit të rekomandimeve janë përcjellë shkresat :

- ✓ Urdhëri i Ministrit të BUMK nr. 310 datë 14.11.2011 me nr. 5335/1 prot, « Për kryerje auditimi » dhe « Planifikim angazhim auditimi » me nr.5335, prot,date 14.11.2011.

Ky auditim u krye nga data 30.11.2011 deri në datën 13.12.2011.

Auditimi përfshiu 27 entitete nga të cilat 5 janë Drejtori Rajonale të Bujqësisë, 9 Borde Kullimi, 5 Qendra të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore, 4 Tregje dhe 1 Depo e Manipulimit të patates, 1 Agjenci, 1 Institut, dhe 1 Ent Shtetëror i Farave dhe Fidanave.

- **Gjatë periudhës Tetor 2010 deri në Tetor të vitit 2011 janë rekomanduar gjithsej 187 Masa Organizative (rekomandime dhe çdëmtime). Nga të cilat:**

- **39** rekomandime e çdëmtime rezultojnë në **DRB**
- **66** rekomandime e çdëmtime rezultojnë në **BK**
- **41** rekomandime e çdëmtime rezultojnë në **QTTB**
- **12** rekomandime e çdëmtime rezultojnë në **ISUV Tiranë**
- **22** rekomandime e çdëmtime rezultojnë për **tregjet dhe Depon e Manipulimit të patates.**
- **2** rekomandime e çdëmtime rezultojnë në **AKU**
- **5** rekomandime e çdëmtime rezultojnë në **ESHFF Tiranë.**

» *Niveli i zbatimit të rekomandimeve të mësipërme paraqitet :*

- **105** rekomandime janë zbatuar.
- **72** rekomandime janë në proçes realizimi.
- **9** rekomandime **nuk** janë zbatuar.
- **1** rekomandim rezultoi i **pamundur** për tu realizuar në **QTTB Vlorë**, pasi laboratorit In-vitro nuk është vënë në efijencë por është mbyllur.

- **Janë rekomanduar për 27 persona Masa Disiplinore e Gjoba nga APP**

Nga të cilat:

- 16 masa disiplinore “Vërejtje” dhe
- 11 gjoba të vendosura nga APP-ja në vlerën prej 550 000 lekë. si rezultat i shkeljeve të konstatuara në auditimin e QTTB Korçë, B.K. Shkodër etj, nga auditët e MBUMK.

» *Niveli i zbatimit të rekomandimeve të mësipërme paraqitet :*

- 16 rekomandime janë zbatuar.
- 11 rekomandime janë në proces realizimi.

16 personave të cilëve u janë dhënë masat janë në institucionet e varësisë.

- **Për 489 persona e subjekte, janë dhënë në total, masa ç’dëmtimi dhe administrative në shumën 22 918 521 lekë (22 437 81 +574 740).**

❖ *Niveli i zbatimit të rekomandimeve të mësipërme paraqitet :*

- Nga personat dhe subjektet qe jane debitorë është **arkëtuar vlerë 5 716 808 lekë ose 25%.**

- Nga personat dhe subjektet qe jane debitorë ***nuk është arkëtuar ende vlera 16 626 973 lekë, pasi shuma prej 574 740 lekë paraqet shkelje të disiplinës financiare pa dëm ekonomik., shume e cila është në proces realizimi.***

Nga:

Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë :

Është konstatuar vlera prej 2 971 287 lekë për çdëmtim, janë arkëtuar 1 347 348 lekë ose 45%, është në proces vlera prej 1 587 939 lekë.

Bordet e Kullimit:

Është konstatuar vlera prej 3 872 144 lekë për çdëmtim, janë arkëtuar 588 887 lekë ose 15%, është në proces vlera prej 2 708 517 lekë, përfshirë dhe vlera prej 574 740 lekë shkelje të disiplinës financiare pa dëm ekonomik.

Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore:

Është konstatuar vlera prej 11 522 232 lekë për çdëmtim, janë arkëtuar 580 952 lekë ose 5%, është në proces vlera prej 9 155 481 lekë dhe është pa realizuar vlera prej 1 785 799 lekë.

AKU

Është konstatuar vlera prej 388 885 lekë për çdëmtim, janë arkëtuar 0 lekë ose 0%, është në proces vlera prej 388 885 lekë.

E.Sh.F.F Tiranë

Është konstatuar vlera prej 1 003 120 lekë për çdëmtim, janë arkëtuar 957 499 lekë, është në proces vlera prej 45 621 lekë.

I.S.U.V. Tiranë

Është konstatuar vlera prej 3 160 853 lekë për çdëmtim, janë arkëtuar 2 242 122 lekë ose 71%, është në proces vlera prej 918 731 lekë.

❖ Ndër rekomandimet e lëna për masa zhdëmtimi, nga verifikimi i kryer rezultoi se:

- ✓ niveli i arketimeve paraqitet tepër i ulët në **vlerë 5 716 808 lekë ose 25%.**
- ✓ nga shuma totale prej 22 918 521 lekë ende janë **pa u arkëtuar 16 626 973 lekë.**
- ✓ Për të gjitha vlerat e mësipërme të detyrimeve, ende të pa arkëtuara, entitetet janë në ndjekje dhe në proces të vjeljes së tyre.

Për vitin 2011, gjatë veprimtarisë së DAB, veçojmë këto aspekte :

1. Krahas zbulimeve dhe masave të rekomanduara , rëndësi e veçantë i është kushtuar ndjekjes dhe zbatimit të masave të rekomanduara si një element i rëndësishëm në vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë audituese.

Bazuar në Programin e Vjetor të Auditimit dhe në zbatim të Urdhërit nr 70, datë 18.04.2006 të Kryeministrit “ Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në Institucionet në Varësi të Kryeministrit a të Ministrave “, pranë entiteteve është kryer auditimi tematik me drejtim : « Verifikim i zbatimit të rekomandimeve, detyrave dhe masave në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr 70, datë 18.04.2006. DAB ka hartuar informacionin përmbledhës.

2. Vlen të përmendim se në çdo praktikë të auditimit është bërë identifikimi dhe vlerësimi i rriskut i cili ka ndikuar në arritjen e objektivave të entitetit.

3. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Toka dhe Ujra ka realizuar përmirësimin e kuadrit ligjor për Bordet e Kullimit në lidhje me kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit si dhe të mbrojtjes nga përmbytjet me Urdhërin nr 351, datë 20.12.2011 dhe është në proces të përmirësimit edhe në strukturat e tjera (QTTB).

Mbi zbatimin e standarteve, për sigurimin e cilësisë së auditimit.

Nga shqyrtimi për sigurimin e cilësisë të praktikave të auditimit, rezulton se përgjithësisht ato janë konformë standarteve dhe praktikave profesionale të auditimit me konkretisht :

- janë dhënë opinione profesionale të mbështetura në gjykime objektive.
- Raportet e auditimit janë përgatitur me kompetencë e profesionalizëm.

Megjithatë duhet pranuar se në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të zbatimit të standarteve të auditimit, **gjithnjë ka vend për më tepër, duke patur parasysh se keto kërkesa nuk mbeten statike.**

Krahas punës se bere dhe rezultateve për sigurimin e cilësisë, janë vërejtur edhe disa mangësi në zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm për të cilat do të bëhen **me implementimin e Manualit të ri të auditimit.**

Mardhëniet e bashkëpunimit me institucionet.

Në veprimtarinë e saj Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka mbajtur marrëdhënie korrekte institucionale të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me :

- Drejtorinë e Përgjithëshme të Auditimit të Brendshëm në M.F.
- Drejtoritë homologe pranë Institucioneve qëndrore.
- Drejtoritë brenda Aparatit të MBUMK, për një koordinim dhe një qëndrim sa më të plotë dhe real në konkluzionet e auditimit, si Drejtorinë e Përgjithëshme të Politikave Bujqësore, Drejtorinë e Përgjithëshme të Sigurisë Ushqimore Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtorinë e Shërbimeve Juridike .

Lidhje të vazhdueshme kemi patur me KLSH, me domosdoshmërinë dhe ***synimin për të:***

- o Zvogëluar në maksimumin e mundshëm mbivendosjen e auditimit apo shmangur dublimet e panevojëshme.
- o Ndjekur rekomandimet e tyre.

- Sigurimin dhe koordinimin e të gjitha përpjekjeve në kuadër të zbatimit të planit të auditimit.

Objektivat e vitit 2012.

Objektivi kryesor i DAB, për vitin 2012 mbetet :

- Zbatimi i Ligjit të ri Nr. 10318, datë 16.09 2010 “Per Auditin e Brendshëm në sektorin publik“
- Zbatimi i Manualit të ri nr. 69, datë 29.09.2010 „Miratimi i manualit ...“
- Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore në funksion të ngritjes cilësore të veprimtarisë audituese dhe intensifikimin e gjithanshëm të përpjekjeve për përsosjen e performancës.
- Kryerja e auditimeve me cilësi, efektivitet sa më të lartë dhe me profesionalizëm.
- Dhënia e mendimeve të specializuara ligjore dhe profesionale.
- Zbatimi i standarteve të auditimit dhe kodit etik në komunikimin me subjektet objekt auditimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit gjatë zbatimit të procesit të auditimit.
- Konsolidimi i mëtejshëm i marrdhënieve të bashkëpunimit me institucionet: KLSH, Drejtorinë e Përgjithëshme të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Strukturat e Auditimit të Brendshëm në subjektet e varësisë.
- Dhenie mendimi për përmirësimin e kuadrit ligjor etj.

DREJTOR
Festime TREBICKA